



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDIERIN Z.KOSTANDIN KOLANI**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga **Qendra Spitalore Rajonale Berat** me nr. 6330 prot, datë 02.12.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”,

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

I ndjeri **z. Kostandin Kolani**, i braktisur nga familjarët dhe të afërmit, prej shumë vitesh ka jetuar në shtetin Grekë me fëmijët dhe bashkëshorten. Në vitin 2024, pasi është dënuar për dhunë në marrëdhëniet familjare (kjo e pohuar nga të afërmit), është rikthyer në Shqipëri dhe ka jetuar në lagjen “Goricë”. Në muajin nëntor 2024 është paraqitur pranë urgjencës Spitalore Berat dhe pasi i janë bërë ekzaminimet është diagnostikuar me AVC dhe është transportuar drejt QSU Tiranë. Pas ekzaminimeve është rikthyer sërish në Spitalin Rajonal Berat dhe shtruar në pavionin e patologjisë. Gjatë periudhës që ka qenë i hospitalizuar në Spitalin Rajonal Berat për këtë pacient nuk është paraqitur asnjë familjar ose i afërm. Edhe pasi ai ka përfunduar të gjitha ekzaminimet dhe duhej të largohej nga spitali, duke mos gjetur asnjë kontakt të të afërmeve është



hospitalizuar për dy muaj në pavionin e patologjisë pasi situatë e tij shëndetësore ka ardhur duke u rënduar, i paralizuar, nuk mund të ushqehet dhe fliste.

Në datën 26.11.2024 z.Kolani ka ndërruar jetë në këtë pavion, si shkak i vdekjes ka qënë arrest kardio respirator.

Pasi jemi njohur me kërkesën është ngritur grupi i punës për identifikimin dhe vlerësimin e situatës social-ekonomike të familjes. Pas identifikimit, intervistimit të banorëve të lagjes “Goricë”, ku treguan historikun e z.Kolani i cili prej muajsh jetonte i vetëm në banesën e të afërmeve dhe komshinjtë e tij angazhoheshin për sigurimin e vakteve ushqimore.

Duke u bazuar në historikun e rastit dhe në vlerësimin social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit, kërkesës së paraqitur nga **Qendra Spitalore Rajonale Berat**, drejtoria e Shërbimit Social, propozon të përballojë shpenzimet e varrimit, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Bashkëngjitur gjeni:

- 1.Certifikatë familjare.
- 2.Certifikata e vdekjes.
3. Kërkesën nga **Qendra Spitalore Rajonale Berat**.
4. Skedën e Vdekjes.
5. Faturë tatimore nga subjekti funeral.
- 7.Korespondenca me Shërbimin Social.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z.MIKAEL KRUTI**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 16.06.2025, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë,

Z.Mikael Kruti jeton në Rajonin nr. 2, lagjia “28 Nëntori”, në katin e tretë të një pallati ekzistues, banesë në pronësi me të vëllain e tipologjisë 2+1. Nw banesw pa orendi dhe në mungesë të paisjeve elektroshtëpiake. Aktualisht jeton i vetëm pasi është edhe kryefamiljar në sistemin e Z.GJ.C (çertifikata bashkëngjitur). Z. Kruti, rezulton pacient kronik me 7 (shtatë) diagnoza ku identifikohet si më e rënda nga mjeku familjes Coxartrosis bilateral. Prej 01.05.2025 me Vendimin e Komisionit bio-psiko-social është vlerësuar përsëri me diagnozën Coxartrosis bilateral ku ka një dëmtim mesatar dhe ndryshime cilësore në strukturë, në të dyja anët e bacinit.



Ky dëmtim ortopedik i ka vështirësuar lëvizjen ku është vlerësuar për fillimin e terapeive fizike dhe përdorimin e mjeteve ndihmëse si patericë.

Strukturat e Shërbimit Social pasi administruan kërkesën e z.Kruti realizuan vlersimin social-ekonomik të tij ku verifikuan së ku ai banonte dhe dokumentacionin shëndetësorë të ekzaminimeve. Pas vlerësimit u identifikuan vështirësitë ekonomike pasi e ardhura e vetme që ka është pagesa e aftwsisw tw kufizuar.

Nga administrimi i dokumentacionit shëndetësor vërtetohet që z.Mikael Kruti prej vitesh vuan nga disa sëmundje dhe një për të cilave i rrezikon dhe të ecurin. Sëmundja dhe mos kurimi në kohë dhe ne trajtim të specializuar shëndetësorë si pasojë e mungesës së të ardhurave mund ti sjell pasoja edhe më serioze (paralizw). Z.Kruti e ka urgjente kryerjen e një ndërhyrje kirurgjikale e cila nuk rimbursohet, për të mos rrezikuar të ecurin. Diagnoza që atij i rrezikon të ecurin është (coxartrosis bilateral).

Të ndodhur në këto kushte duke u bazuar dhe në kërkesën e bërë nga Z.Mikael Kruti, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat nga strukturat e shërbimit social, vështirësitw social-ekonomike, kushtet ku jeton i vetëm dhe pa asnjë familjar ose të afërm dhe dokumentacionin shëndetësor tw paraqitur, propozojmë që z.Mikael Kruti të mbështetet në masën e 40.000 (dyzet mijë) lekë .

Bashkëngjitur gjeni:

1. Dokumentacion shëndetësor.
2. Çertifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
3. Vendimin e komisionit bio-psiko-social.
4. Vlerësimi social-ekonomik nga administrator i N.E.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

MBI SISTEMIMIN E NURI SHANO SI RAST EMERGJENT REZIDENT PRANË QENDRES PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR “LIRA”.

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Qendra “Lira”, bazuar në Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat me Nr.Vendimi 374, datë 07.05.2025, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” VKM-në Nr.425, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror për PAK” i ndryshuar, ”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”, bazuar në observimin e bërë nga Qendra “Lira” me Nr.109 Prot, datë 03.05.2025, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltar !

Bazuar në propozimin për vendosjen e masës së mbrojtjes ” Masë emergjente të mbrojtjes”, Vendosjen në Përkujdesje Alternative të fëmijës Nuri Shano në institucionin e përkujdesjes Qendra “Lira” në datë 29.04.2025 protokolluar për Drejtorinë e Shërbimit Social me Nr. 32 Prot, datë 29.04.2025 nga PMF dhe miratuar nga Drejtori i Shërbimit Social”, ka nisur menjëherë verifikimi dhe zbatimi i të gjitha procedurave ligjore për sistemimin e **fëmijës Shano** si person me aftësi të kufizuara në Qendrën “Lira”. Gjatë administrimit të dokumentacionit, takimit të Grupit Teknik Ndërsektorial dhe intervistave të familjarëve mbështetur në kuadrin ligjor, rezultoi se : Familja Shano është një familje e cila jetonte në fshatin Kamcisht NJA Sinjë, e përbërë prej 5 anëtarësh, babai, nëna dhe 3 fëmijët, ku fëmija i dytë Nuri Shano, është i diagnostikuar me Cregullim të Spektrit Autik dhe prej vitit 2012 merr pagesë paaftësie. Bashkëshortët Shano prej 2 vitesh kanë kryer zgjidhjen e martesës në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe e kanë apeluar Vendimin por ende nuk kanë arritur të zgjidhin martesën.



Fëmija N.Sh. qëndronte në banesë nga lindja dhe në moshën 9 vjecare është regjistruar në shkollë për herë të parë. Fëmija u regjistrua në shkollë dhe njëkohësisht edhe për terapi në Qendrën “Lira” me mbështetjen e shërbimit psiko-social të shkollave në ato vite. Ndiqte rregullisht prej një viti tek Qendra” Lira” terapitë dhe frekuentonte rregullisht shkollën pasi nëna jetonte në banesë me qera në Berat. Pas qëndrimit në Berat janë rikthyer përsëri në fshatin Kamcisht, shkolla “Paftal” ku është kryer vlerësimi periodik dhe është vendosur edhe mësues mbështetës, Prej qytetit të Tiranës në vitin 2023 ka emigruar me djalin dhe vajzën e vogël pa dijeninë e të atit në shtetin Francez ku i ati ka bërë edhe një kallëzim në qytetin e Beratit dhe më pas nëna është rikthyer pas 6 muajve. Prej afër një viti e ka braktisur fëmijën duke e lënë në kujdestarinë e të atit dhe njerks në fshatin Kamcisht edhe pse ajo ishte Ndhmësia Personale e fëmijës me aftësi të kufizuara sipas Vendimit të KM, nr. 874, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal”, ku detyrat e ndihmësit janë të përcaktuara në pikën 5 të këtij Vendimi. Me pretendimet e saja që nuk mund të plotësonte nevojat e fëmijës në qytetin e Tiranës edhe pse I ati shpesh herë ju dërgonte të ardhura ekonomike.

Është vlerësuar marrja e fëmijës në mbrojtje pasi niveli i rrezkut është emergjent, stili i jetesës së nënës, problemete e saj të sjelljes, ku prej vitesh nuk shfaq interes dhe vëmendje për zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijës AK. Shfaq neglizhencë dhe nuk merr në konsideratë nevojat specifike të fëmijës ku vazhdimisht është e orientuar drejt aspektit financiar dhe ekonomike prej ish bashkëshortit dhe insitucioneve. Nuk ka prioritet stabilitetitn psiko-emocional të fëmijëve dhe ju përcjell atyre ngarkesat e saj si kujdestare duke cuar në konfuzion të roleve, ku vajzat marrin përsipër rolet prindërore, zgjidhjen e problemeve dhe vendimarrjen. Gjatë kohës që nëna ka braktisur fëmijën dhe është larguar në Tiranë ka përfituar si kujdestare ligjore, ndihmëse personale sipas ligjit Nr. 874 datë 24.12.2019 “Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal;” duke mos realizuar kujdesin primarë sipas këtij ligji. Babai i fëmijës Eduart Shano, aktualisht jeton dhe punon si emigrantë ekonomik i pa pajisur me dokumenta qëndrimi në shtetin Grek. Kjo mënyrë jetese dhe puna e tij është një zgjidhje prej vitesh për sigurimin e të ardhurave për familjen. Prej një viti ai me bashkëjetuesen janë kujdesur për fëmijën AK dhe bashkëjetuesia ka luajtur rolin e ndihmësit personal të fëmijës. Gjatë kësaj periudhe ai është shkëputur me periudha të shkurta në shtetin Greke duke lënë fëmijën nën kujdesin e bashkëjetuese së tij, e cila ka edhe një fëmijë të mitur. Midis babait, bashkëjetueses dhe nënës së fëmijës ka një konflikt të ashpër i cili ka përshkallëzuar disa herë dhunë verbale dhe sulme verbale për të cilat ka edhe denoncime në komisariat dhe së fundmi një konflikt fizik me pasoja të rënda për shëndetin e bashkëjetueses së z.Eduart. Me gjithë këto konflikte, babai, për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe nevojave ekonomike të familjes, nuk po kthehet në Shqipëri për të marr përsipër detyrimet prindërore.



Bazuar në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e administruar, Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, drejtoria e Shërbimit Social, Qendra “Lira” dhe koston shtesë financiare që duhet për të miturin, miratojmë Nuri Shano të sistemohet si rast emergjent rezidente, pranë Qendrës “Lira”.

Bashkëngjitur relacionit gjeni dokumentacionin :

1. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
2. Propozimi për vendosjen e masës së mbrojtjes ” Masë emergjente të mbrojtjes”, Vendosjen në Përkujdesje Alternative të fëmijës Nuri Shano në institucionin e përkujdesjes Qendra “Lira”.
3. Miratimi i masës së mbrojtjes
4. Vendimi i Komisionit Bio-Psiko-Social për përcaktimin e aftësisë së kufizuar.
5. Vërtetim Vendbanimi .
6. Çertifikata të ndryshme.
7. Formular tip 2.
8. Tabela me kosto financiare për periudhën 01.06.2025 - 31.12.2025.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

**MBI MIRATIMIN E STREHIMIT TE DHOMA NË KATIN E II TE OBJEKTIT ISH-KURSI I
PARTISË LAGJA “30 VJETORI”**

Të nderuar Këshilltarë!

Komisioni i Strehimit i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.347, datë 16.06.2023 i ndryshuar, i mbledhur më datë 11.06.2025, mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Sektori i Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit në lidhje me ndarjen e një dhome të ndodhur në katin e dytë të godina e Ish –Kursit të partisë në lagjen “30 Vjetori” me nr.15/269+1-19 pasurie.

Objekti ish-kursi i partisë është kthyer në fond banese me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.11, datë 13.03.2013. Në këtë vendim është miratuar strehimi i 20 familjeve të pastreha ku 17 familjet e strehuara e kanë privatizuar ambjentin e marë me VKB, ndërsa tre familje nuk e kanë privatizuar akoma.

Një ambjent i përbërë nga një dhomë dhe tualet është bosh, pasi familja që ishte strehuar në të u largua.

Për këtë ambjent ka bërë kërkesë z. Kostaq Kule pasi ka vetëm një dhomë me sipërfaqe 9 m², pa tualet. Ka aplikuar pranë bashkisë për leje për ndërtimin e tualetit në dhjetor të vitit 2022, por është refuzuar nga bashkia, me argumentin se nuk lejohet ndërtimi i tualetit në ballkon siç kanë vepruar banoret e tjere të cilët e kanë ndërtuar shumë herët. Me shkresën nr.1103 prot, datë 09.10.2023, qytetari ka bërë kërkesë pranë zyrës me një ndalesë për marrjen me qira të dhomës që është ngjitur me dhomën e tij. Kjo familje është e përbërë nga një çift pensionistësh, aktualisht banojnë me qira, kjo pasi dhoma që kanë privatizuar të ish –kursi i partisë nuk ka tualet dhe me të ardhurat që kanë vetëm nga pensioni e kanë të pamundur të mbulojnë qiranë e banesës. Po kështu kjo familje ka bërë aplikim për banesë sociale në portalin e-albania.

Për këtë dhomë ka bërë kërkesë me nr.785 prot, dt 05.06.2025 pranë zyrës me një ndalesë edhe Dritan Canko, familje e përbërë nga 2 persona i cili ka privatizuar 1 dhomë dhe një tualet si dhe ka zënë një pjesë të koridorit të katit të dytë, por që ambjentet që ka privatizuar nuk janë me murr të përbashkët me dhomën pronë e bashkisë.

Po kështu ky ka aplikuar në portalin e-albania më dt 12 Janar 2025 për bonus qiraje, por është s’kualifikuar pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin përkatës për t’u trajtuar me programin e bonusit të qirasë.

Në përfundim Komisioni i Strehimit pasi mori në shqyrtim të dyja kërkesat si dhe sistemin e pikëzimit i miratuar me VKB nr.14, datë 05.03.2025 i cili bazohet në kushtet e strehimit, kushtet familjare, kushtet sociale si dhe kushtet ekonomike renditja është si më poshtë:

3
1.Familja e Kostaq Kules me 24 pikë e përbërë nga :Kushtet e strehimit 7 pikë, pasi banon në banesë që nuk ka kushtet minimale i mungon tualeti; Kushtet familjare 5 pikë, të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit; Kushtet Sociale 0 pike; Kushtet ekonomike 12 pike. Të ardhurat familjare janë 80 %-100 % të të ardhurave mesatare.

2.Familja e Dritan Cankos me 23 pikë e përbërë nga :Kushtet e strehimit 5 pike, pasi banon në banesë me sipërfaqe nën normat e strehimit; Kushtet familjare 0 pikë; Kushtet Sociale 6 pike; Familja që kanë në përbërjen familjare PAK dhe invalide; Kushtet ekonomike 12 pike.Të ardhurat familjare janë 80 %-100 % të të ardhurave mesatare.

Komisioni i Strehimit vendosi të strehojë Kostaq Kulen familjarisht në dhomën me nr.15/269+1-19 pasurie, ndodhur në katin e dytë të objektit ish-Kursi i Partisë ,Lagja “30 Vjetori” .

Kërkojmë nga Ju të nderuar Keshilltarë miratimin e strehimit familjar të Kostaq Kules në dhomën me nr.15/269+1-19 pasurie, ndodhur në katin e dytë të objektit ish-Kursi i Partisë ,Lagja “30 Vjetori”

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT TË MBROJTJES CIVILE

Të nderuar këshilltarë!

Nisur nga verifikimet në teren të zonave të riskut të cilat përbejnë rezik për jetën e qytetarëve, si dhe kërkesave të vazhdueshme të tyre për rezikshmërinë që paraqesin muret mbajtëse dhe terrene në Bashkinë Berat konkretisht :

- Fshati “Vojnik”, Njësia Administrative Roshnik mungojnë muret pritës përgjatë rrugës, duke rrezikuar stabilitetin dhe integritetin strukturor të objekteve të banimit dhe rrugës: vlera 433,013.9 lekë me tvsh, l=15 ml.
- Fshati “Osmezezë”, Njësia Administrative Sinjë, kemi rreshqitje të konsiderueshme të dherave duke rrezikuar stabilitetin dhe integritetin strukturor të objekteve të banimit vlera: 866,027.90 lekë me Tvsh me gjatesi l=30ml.
- Fshati “Memias-Qaf e Pusit” , Njësia Administrative Roshnik kemi mungesë të murreve mbajtës në këtë segment e cila cënon integritetin dhe stabilitetin e trupit të rruges: vlera 2,219,982.7 lekë me tvsh me gjatesi L=33 ml.
- Lagjia “28 Nëntori” , Rajoni Nr.2 kemi mungesë të mureve mbajtës në këtë segment duke rrezikuar stabilitetin dhe integritetin strukturor të objekteve të banimit dhe trupit të rrugës vlera: 3,494,553.2 lekë me tvsh, l=85 ml.
- Lagjia “28 Nëntori” pranë shtëpisë së z.Perparim Sulovari, Rajoni Nr.2 kemi mungesë të murreve mbajtës në këtë segment duke rrezikuar stabilitetin dhe integritetin strukturor të objekteve të banimit dhe trupit të rrugës: vlera 1,169,328.5 lekë me tvsh, l=35 ml.
- Fshati “Karkanjoz”, Njësia Administrative Roshnik mungojnë muret mbajtës përgjatë rrugës, duke rrezikuar stabilitetin e rrugës vlera: 1,113,917.90 lekë me tvsh, l=26 ml.

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1 gërma b, pika 5 , shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr. 2126/1 prot datë 19.02.2025” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2025” ku Bashkisë Berat i është akorduar fondi në shumën 11,521,812.34 lekë, ju sjellim propozimet tona për të përdorur fondin e akorduar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile si më poshtë :

- të përdoret shuma 9,296,824.10 lekë për projektin “ Ndërhyrje rehabilituese në mure mbajtës dhe terrene në territorin e bashkisë, në kuadër të mbrojtjes civile”, bashkangjitur relacionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronave të tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike , në përputhje me pikën 3.1 gërma b të VKM-së.

Bashkëngjitur do të gjeni dokumentacionin teknik.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË I KOMANDUAR

Ervin CECA

Drejtorja e PLANIFIKIMIT URBAN Arjana Marini-drejtor

Drejtorja e MCPTSH Sokol Toska-Drejtor

Drejtorja e Menaxhimit Financiar Rovena Shehu-drejtoresh



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT TE PYJEVE, UJERAVE DHE SHERBIMIT
VETERINAR

LËNDA: PËR MIRATIMIN E VENDGROPOSJES PËR KAFSHËT E NGORDHURA
NGA SËMUNDJA E PESTË E RUMINANTËVE TË VEGJËL NË TERRITORIN E
BASHKISË BERAT

KËSHILLIT BASHKIAK – BERAT

Të nderuar Këshilltar!

Bazuar në ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen vendore”, ligjin Nr 10465 datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar, VKM Nr 475 datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e Njërive të Vetqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar”, Urdhëri Nr 802, datë 09.10.2024 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për Sëmundjen e Murtajes së Ruminantëve të vegjël (Peste des petits ruminants (PPR), Urdhëri I Ministrit Nr 56, datë 04.06.2025 “Për funksionimin e Qendrës Rajonale të Krizës”, Urdhër Nr 62 datë 09.02.2018 “Për Miratimin e Rregullave për marrjen e masave për eliminimin e kafshëve”

Murtaja e Ruminantëve të Vegjël është një infeksion viral që përbën kërcënim të konsiderueshëm për delet, dhitë dhe disa thundrakë të egër. Sëmundja prek rëndë prodhimin e qumështit dhe mishit, por nuk transmetohet te njerëzit. Ky infeksion përhapet në mënyrë të shpejtë te kafshët, duke sjellë mortalitet 100% të tufës ku shfaqet.

Murtaja po shtohet me ritme të shpeshta, çdo ditë kemi raste të dyshuara të përhapura nga veriu në jug të Shqipërisë. Lëvizja e pakontrolluar dhe futja apo shitja e kafshëve në rrugë rrezikon të përhapë më tej sëmundjen. Kjo sëmundje emergjente dhe serioze e cila prek kafshët rrezikon në

4

masë dhe ekonominë blegtorale të vendit. Monitorimi i kësaj sëmundje kërkon kontrolle 24/7 në terren nga Strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke përfshirë dhe organet kyç të Pushtetit Vendor.

Është shumë e rëndësishme që të ndërgjegjësohen fermerët për të zbuluar dhe raportuar shenja klinike që shfaq ky infeksion, (të tilla si temperaturë e lartë, diarre, rrjedhje nga hundët, lotim të syve).

Për të kuptuar rëndësinë e sëmundjes, përhapjen së saj të shpejtë është kërkuar angazhim i menjëhershëm dhe i koordinuar nga të gjitha Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për të menaxhuar në mënyrë efektive përhapjen e mëtejshme të sëmundjes. Për të minimizuar këtë rrezik potencial që kanoset dhe që të sigurohet një reagim i shpejtë në çdo situatë të mundshme Njësia e Pushtetit Vendor është ngarkuar me përcaktimin e vendgroposjes për kafshët e ngordhura sipas kriterëve ligjore dhe teknike.

Kërkojmë :

Miratimin e vendgroposjes për kafshët e ngordhura nga përhapja e sëmundjes së Murtajes së ruminantëve (Peste des petits ruminants PPR) bazuar në Urdhër Nr 62 datë 09.02.2018 "Për Miratimin e Rregullave për marrjen e masave për eliminimin e kafshëve" sipas Shtojcës 1 të Urdhërit. Duke pasur parasysh udhëzimet e Urdhërit të sipërpërmendur propozojmë vendet e groposjes me të dhëna kadastrale në territorin me nr e pasurisë 176/2, fshati Gjoroven, Njësia Administrative Velabisht si dhe në territorin me nr e pasurisë 1331, ZK 2833, fshati Orizaj, Njësia Administrative Otlak, Bashkia Berat, me hartë treguese me nomenklature K-34-112-~~(206-A)~~, (206-B) sipas hartës bashkëlidhur.

Bashkëlidhur me këtë relacion do të gjeni:

- VKM Nr 475 datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e Njësive të Vetqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar”,
- Urdhëri Nr 802, datë 09.10.2024 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për Sëmundjen e Murtajës së Ruminantëve të vegjël (Peste des petits ruminants (PPR),
- Urdhëri i Ministrit Nr 56, datë 04.06.2025 “Për funksionimin e Qendrës Rajonale të Krizës”,
- Urdhër Nr 62 datë 09.02.2018 “Për Miratimin e Rregullave për marrjen e masave për eliminimin e kafshëve”
- Planvendosja e parcelës së propozuar dhe gjurma e vendit ku do të hapet gropa për groposje
- Vendim të Këshillit Bashkiak Nr 76 datë 29.06.2016 “Mbi miratimin e shesh depozitimit të mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Otlak, fshati Orizaj, Bashkia Berat

Ju faleminderit!

Konceptoi:

Marinela Çifliku

Amza Margjoni

Myslim Çifliku

Guxim Toska

DREJTORI D.B.AP.U & SHV

Bledar Çili

